



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Prishtinës
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61.3. lidhur me nenin 62 paragrafi 62.1 nënparagrafi d) si dhe nenin 63 paragrafi 63.1 nënparagrafi 63.1.1 të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik "Demaj ing" Sh.P.K. të datës 01.04.2025 kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Ndërtimi i rrethojave të varrezave të Komunës së Prishtinës" me nr. të prokurimit 616-25-1830-5-1-1, Komuna e Prishtinës (Autoriteti Kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. REFUZOHET si e pabazuar** kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "Demaj ing" Sh.P.K. të datës 01.04.2025 kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Ndërtimi i rrethojave të varrezave të Komunës së Prishtinës" me nr. të prokurimit 616-25-1830-5-1-1.
- II. LEJOHET** autoriteti kontraktues që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit me të dhënat si në pikën I të këtij vendimi.
- III.NJOFTOHEN** palët e interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV.** Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Operatori ekonomik "Demaj ing" Sh.P.K. (tutje "parashtruesi") me datë 01.04.2025 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Ndërtimi i rrethojave të varrezave të Komunës së Prishtinës" me nr. të prokurimit 616-25-1830-5-1-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (*in meritum*) të kërkesës.

Pretendimet e parashtruesit janë cituar si në vijim:

"Ju si Autoritet Kontraktues, te Kapaciteti teknik dhe professional keni kerkuar te Kerkesa 3. Një (1) Inxhinier të makinërisë Bachelor apo Master me 3 vite pervoj pune pas diplomimit i certifikuar me IWS nga IIW dhe te Kerkesa 6. Një (1) teknik të makinërisë, i trajnuar per siguri dhe shendet ne pune dhe mbrojtje nga zjarri. Ju lutemi na sqaroni a eshte i mundur qe Inxhinier I makinërisë me 3 vite pervoj pune pas diplomimit i certifikuar me IWS nga IIW, i trajnuar per siguri dhe shendet ne pune dhe mbrojtje nga zjarri, ti plotesoj keto dy kerkesa.

Poashtu ju si AK keni te Kerkesa 12 keni kerkuar qe Operatori ekonomik duhet te jetë i pajisur me Certifikata ISO •Certifikata ISO 45001 2018 – valide •Certifikata ISO 14001 2015– valide •Certifikata ISO 9001 2015 – valide •Certifikata ISO 3834-2:2005 – valide •Certifikata ISO 4063 - 2023– valide •Certifikata ISO 1090-1:2009 A1 – valide. Kerkojme nga ju qe t'i rishqyrtoni kerkesat per keto Iso standarde: 1. ISO 3834-2:2005 (Menaxhimi i cilësisë së saldimit) • Kjo certifikatë është e nevojshme për kompanitë që kryejnë saldim industrial në procesin e prodhimit. Në rastin tonë, ne vetëm montojmë rrethojat dhe nuk kryejmë saldim gjatë prodhimit të tyre. Prandaj, kjo certifikatë është e panevojshme për operatorët ekonomikë që nuk janë prodhues. 2. ISO 4063:2023 (Identifikimi i proceseve të saldimit dhe prerjes termike) • Ky Iso eshte thjesht nje standard per klasifikimin e proceseve të saldimit, por nuk ka lidhje me cilësinë apo sigurinë e punës në një projekt montimi. 3. ISO 1090-1:2009 A1 (Prodhimi i konstrukteve metalike – Shenja CE) • Ky standard është i detyrueshëm për prodhuesit e konstrukteve metalike, të cilët duhet të pajisen me shenjën CE për produktet e tyre. Në rastin tonë, ne nuk jemi prodhues, por vetëm montues. Prandaj, kjo certifikatë nuk duhet të kërkohet për operatorët ekonomikë që nuk prodhojnë konstruksione metalike. Kerkojme nga ju si AK qe ti largoni keto Iso standard pasi jane te panevojshme dhe favorizuese per nje kompani te caktuar dhe sit e tilla e minojne aplikimin per shume kompani".

Përmes nenit 10 paragrafit 10.3 të RRPP është përcaktuar se njësia kërkuuese ndër të tjera ka përgjegjësinë për të përgatitur detyrën projektuese, projektin, specifikimet teknike, termat e referencës, paramasën dhe parallogarinë. Përmes nenit 11 paragrafit 11.3 të RRPP përcaktohet se zyrtari i prokurimit ndër të tjera në bashkëpunim me njësinë kërkuuese i koordinon dokumentet, projektet, specifikimet, termat e referencës, paramasat, parallogaritë dhe vizatimet. Në këtë rast zyrtari përgjegjës i prokurimit i ka falur besimin e plotë përcaktimeve të njësisë kërkuuese.

Lidhur me pikën e parë të pretendimit ankimor, duhet cekur se parashtruesi nuk e konteston kërkesën si të tillë por më shumë kërkon shpjegime dhe aq më pak nuk prezanton argumente sipas të cilave kërkesa nuk do të ishte në përputhje me ndonjë dispozitë të LPP. Rrjedhimisht nuk është kontestuese se kërkesa është e nevojshme në fakt e domosdoshme dhe në përputhje të plotë me qëllimin e aktivitetit të prokurimit. Po ashtu kërkesa është formuluar në mënyrë të saktë dhe të kuptueshme. Përtej kësaj, AK qëndron edhe prapa sqarimeve eventuale që kanë mundur të ofrohen për të gjithë tenderuesit në fazën e sqarimit të kërkesave të dosjes së tenderit. Prandaj pretendimi është i pabazuar.

Lidhur me pikën e dytë të pretendimit ankimor, certifikatat ISO janë kërkuar nga AK në përputhje të plotë me LPP (shih nenin 69, 70, et.al. të LPP). Këto certifikata të kërkuara sipas DT, secila prej tyre veçmas dhe të gjitha së bashku, janë absolutisht të domosdoshme për të garantuar standardin e domosdoshëm të cilësisë që nevojitet për të realizuar me sukses kontratën që synohet të lidhet nga ky aktivitet i prokurimit. Prandaj edhe ky pretendim ankimor është i pabazuar në tërësi.

Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij. Prandaj kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është refuzuar si e pabazuar në tërësi.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.1.1. lidhur me nenin 62 par. 62.1. të RRPP. Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.2. të RRPP.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 08.04.2025

Visar SHEHU

Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Prishtinës

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.